



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.01.2024, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik "ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K; Benita Company; Dreoni SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve ekonomik "ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K; Benita Company; Dreoni SH.P.K., e dt.29.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 22.01.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 22.01.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.29.01.2024, Grupi Operatorëve ekonomik "ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K.; Benita Company; Dreoni SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me

aktivitetin prokurimit: **"Ndërtimi i Rrugës X"**, Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.01.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara, sepse në Vendimin e OSHP-së nr.2023/0560, të dt.08.12.2023, tek "Arsyetimi", faqe 5, decedivisht thuhet se Grupi i Operatorëve ekonomik ankues "ASFALT GROUP" SH.P.K; Gurëbardhi SH.P.K; Benita Company; Dreoni SH.P.K., **nuk janë të përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.**

Autoriteti kontraktues ka vendosur të bëjë anulimin e aktivitetit në fjalë, në bazë të kërkesës së njësishë kërkuese, pasi që nga Ministria për Infrastrukturë është prezantuar projekti ideor për zgjerimin e rrugës Rajonale R107 (Istog – Prizren).

Kjo rrugë parashihet që të përfshijë edhe segmentin e Rrugës X (Skivjan – Lugbunar), që do të jetë rrugë e kategorisë rajonale.

Andaj, për shkak të kategorizimit të kësaj rruge si rrugë Rajonale, që sipas Nenit 3, paragrafi 5.1 të LIGJIT Nr. 03/L-120 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR RRUGË, NR. 2003/11, kjo rrugë i takon Ministrisë, po ashtu duke u bazuar në projektin që Ministria po zhvillon, kjo rrugë do të financohet dhe ndërtohet nga Ministria e Infrastrukturës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Kësbilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës